



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:015938

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05736757

KPPP.nr. 91/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “CGV” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811849530, me seli në Prishtinë, rr. “Bajram Kelmendi”, nr. 15, kati II, duke vendosur sipas propësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 504/23, i lejuar më datë 21.12.2023, nga Përmbaruesi Privat Driton Govori, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 27.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET, në tërësi si i pabazuar propësimi i debitorit “CGV” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811849530 dhe seli në Prishtinë, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 504/23, i lejuar më datë 21.12.2023, nga Përmbaruesi Privat Driton Govori.
- II. Urdhri Përmbarimor P.nr. 504/23, i lejuar më datë 21.12.2023, nga Përmbaruesi Privat Driton Govori, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, mbi bazën e dokumentit përmbarimor; Vendimit Nr. 01/50-201/23-Gj, të datës 05.09.2023, ka lejuar Urdhrit Përmbarimor P.nr. 504/23, të datës 21.12.2023, me të cilin është obliguar debitori “CGV” Sh.P.K., që menjëherë pas pranimit të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj në emër të masës ndëshkimore vlerën prej EUR 1,200.00, së bashku me shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur propësimit me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbarimor nuk i

plotëson kushtet e parapara ligjore për t'u konsideruar dokument përmbartimor dhe i përshtatshëm për përmbartim. Ndërsa, ka theksuar se inspektorati ka tejkaluar kompetencat e gjykatës me rastin e nxjerrjes së vendimit objekt përmbartimi. Më tej, ka theksuar se vendimet e Inspektoratit janë vendime të nxjerra pa një kontest të rregullt të punës, e të bëra të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme nga vetë Inspektorati, që do të thotë se janë vendime të njëanshme. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që propozimin për përmbartim ta hudhë poshtë si të pa lejuar.

Kreditore, në përgjigje në prapësim ka theksuar se propozimin për përmbartim e ka parashtruar si rezultat i mos pagesës së detyrimeve të debitorit në mënyrë vullnetare për pagesë të gjobës së shqiptuar sipas vendimit të formës së prerë të TEIP. Ka shtuar se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor është i bazuar dhe i ekzekutueshëm. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor përkatësisht vendimin mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafin 1, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi Nr. 01/50-201/23-Gj, i datës 05.09.2023, mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, është bërë i plotfuqishëm dhe mban vullën e ekzekutueshmërisë së datës 10.11.2023, dhe rrjedhimisht i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me*

propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmëris për përmbarrueshmëri”, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: “Vërtetimin për përmbarrueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”.

Gjykata, ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njejtat janë të pabazuara dhe nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarrimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës.

Nga sa më sipër, bazuar duke u bazuar në 73, paragrafi 1 dhe 3, të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 91/24, datë 27.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.